



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 660/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtare
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.10.2015 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, datë 10.09.2015 në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Zenit-06” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt Loti III “Mbikqyrja e Punimeve për objektin: Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, loti III”, me fond limit 915,355 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

**Ankimues:**

“Zenit-06” sh.p.k.  
Rruga Myrteza Topi, ndërtesa 18, Hyrja 7, Ap.38,

**Autoritet Kontraktor:**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar nën 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të operatorëve ekonomikë ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

II. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka pranuar pjesërisht atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.07.2015 është publikuar në portalin elektronik të prokurimeve, procedura e prokurimit “Kërkesë Për Propozime”, me objekt Loti II “Mbikqyrja e Punimeve për objektin: Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat loti III”, me fond limit 915,355 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 04.09.2015 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 10.09.2015, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, nëpërmjet portalit elektronik të prokurimeve, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

“I.S.P.P”	Pa ofertë	I skualifikuar
“Alb -Supervizion”	500000.00	I skualifikuar
“Zenit-06”	595000.00	I skualifikuar
“Infratech”	718300.00	I kualifikuar
“Novatech-Studio”	832973.00	I kualifikuar

II.4. Në datën 15.09.2015, operatori ekonomik ankimues “Zenit-06” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, më anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-se për skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi me arsyet se:

1. *Formulari i ofertës nuk është sipas formularit të dhënë në Dokumentat Standarte të Tenderit dhe në të nuk është shënuar vlera pa TVSH dhe me TVSH.*
2. *Oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.704 datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” .*

II.4.1. Në datën 17.09.2015 autoriteti kontraktor, me anë të shkresës nr. 1737/2 prot., i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Zenit-06 ” sh.p.k., duke pranuar pjesërisht ankesën e tij si më poshtë:

1. *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit “Formulari i Ofertës”, pas verifikimit në sistem të dokumentacionit që keni paraqitur u konstatua se Formulari i Ofertës së paraqitur është sipas formularit të dhënë në dokumentat e tenderit dhe në të është shënuar vlera pa tvsh dhe me tvsh.*
2. *Lidhur me arsyen e dytë shoqëria juaj nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor pasi oferta e paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e V.K.M nr.704 datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe koaludim”. Nga përlllogaritjet e bëra nga autoriteti kontraktor rezulton se bazuar në V.K.M e sipërcituar vlera minimale e lejuar për këtë objekt prokurimi është si më poshtë:*

*Loti II: Mbikqyrja e Punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnjë-Berat “Vlera minimale e lejuar është 718.324 lekë pa t.v.sh.*

*Oferta e paraqitur nga shoqëria juaj është 595.000 lekë pa t.v.sh. Për sa më sipër oferta ekonomike e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në VKM nr.704 datë 29.10.2014.*

II.4.2. Në datën 25.09.2015 operatori ekonomik ankimues “Zenit-06.” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me pretendimet si më poshtë:

1. *AK nuk jep shpjegime se si është përlllogaritur vlera 718.324, nuk sqaron dhe nuk ka kërkuar në DT përlllogaritjen nga ofertuesi si pjesë të ofertës se , sa janë shpenzimet*

*për pagat e sigurimet shoqërore/shëndetësore të personelit që do të angazhohet në mbikqyrje, sa orë pune do të jenë ata në objekt, sa janë detyrimet minimale të pagueshme nga ofertuesi që parashikon legjislacioni në fuqi etj.*

2. *Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe rregullat e prokurimit publik përcaktojnë se në rastin e ofertave të vlerave të ulta AK mund të përdorë formulën e ofertës anomalisht të ulët. Pra nëse oferta jonë do të konsiderohej anomalisht e ulët (Formulimin nën cmimin e lejuar nuk e njëh ligji i prokurimit publik, është një shpikje e AK që i duhej për këtë rast sepse nuk është përdorur nga kjo AK në procedura të tjera prokurimi) atëherë duhej të zbatonte përcaktimet e nenin 56 të Ligjit të Prokurimeve duke kërkuar shpjegime me shkrim për cmimin e ofruar.*
3. *Oferta e Zenit-06 sh.p.k plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit duke garantuar zbatimin me sukses të kontratës, ndërkohë që ofron me vlerën më të ulët që janë e që duhet të jenë edhe qëllimet kryesore në një procedurë prokurimi.*

II.9. Në datën 29.09.2015 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar. Në të tjera autoriteti kontraktor sqaron se:

[...]

*Vlera pa tvsh e fondit limit të tenderit për supervizionin e Rehabilitimit të Gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnjë Berat, Loti III, është nga 718,324 deri në 915,355 lekë pa Tvsh.*

*Pra vlerat e fondit limit për supervizionin e lotit III janë midis 718,324 dhe 915,355 lekë pa tvsh.*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit “Oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti

*kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.2. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.3. Në nenin 53, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave [...]”.

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.5. Konstatohet se autoriteti kontraktor nuk i është referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në lidhje me zbatimin e formulës për ofertën anomalisht të ulët, por ka bërë vlerësimin referuar vlerës minimale të fondit limit, duke përcaktuar një diapazon të këtij të fundit për të kualifikuar/skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk është e pranueshme që autoriteti kontraktor të kryejë apo të pretendojë të kryejë vlerësimin e ofertave ekonomike duke vendosur kufij minimalë, nën të cilin do të skualifikohen automatikisht ofertat ekonomike të operatorëve pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, pasi kjo vjen në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, sipas të cilit fillimisht zbatohet formula për të vlerësuar nëse një ofertë është anomalisht e ulët ose jo dhe më pas, në varësi të rezultatit, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë sqarimet dhe dokumentacionin me të cilin ky i fundit argumenton elementët e veçantë të ofertës së tij ekonomike, duke mbajtur në konsideratë edhe legjislacionin e posaçëm që rregullon tarifatat për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

Përcaktimi i kufijve të tillë, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Gjithashtu Komisioni konstaton se, dhe oferta e kualifikuar në vendin e parë si ofertë e suksesshme nga autoriteti kontraktor, është me vlerë më të ulët se kufiri minimal që pretendohet nga vetë autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik “Zenit – 06” qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt Loti III “Mbikqyrja e Punimeve për objektin: Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, loti III”, me fond limit 915,355 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1552 Protokoli, Datë 25.09.2015**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Spiro Kuro**

**Anëtar**  
**Juliana Hoxha**

**Anëtar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Kryetar**  
**Gentian Këri**